

VENDIM
Nr. 17, datë 11.1.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 749, DATË 19.12.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS SHTETËRORE, PËRGJEGJËSE PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE DHE LIDHJEN E TRAKTATIT TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në këtë vendim, emërtimi “Kryenegociator” zëvendësohet me “ministër i Shtetit dhe Kryenegociator”;

b) Në pikën 4, të kreut III, fjalët “... me propozimin e ministrit përgjegjës për Evropën dhe Punët e Jashtme.” zëvendësohen me “... me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator.”;

c) Pika 7, e kreut III, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Këshilli i Ministrave miraton qëndrimin negociues për secilin grup-kapitull të *acquis*-it, me bashkëpropozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator dhe të ministrave që mbulojnë fushën e përgjegjësisë shtetërore për kriteret dhe kapitujt e *acquis*-it, sipas parashikimeve të këtij vendimi.”.

ç) Në pikën 1, të kreut V, në fund të fjalisë shtohen fjalët “... dhe kriteret e Bashkimit Evropian.”;

d) Pika 2, e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Grupi negociator përbëhet nga Kryenegociatori dhe jo më pak se 7 (shtatë) anëtarë. Përbërja e grupit negociator dhe rregullat e funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator.”.

dh) Shkronja “a”, e pikës 3, të kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) diskuton, vlerëson dhe i propozon Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian shqyrtimin e projektpropozimeve për qëndrimet negociuese për çdo grup-kapitull të *acquis*-it, të bashkëpropozuara nga negociatorët përkatës të grup-kapitullit, sipas projektpropozimeve të hartuara nga grupet ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull dhe kriter të *acquis*-it.”.

e) Pika 4, e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator i paraqet për shqyrtim Komisionit për Çështjet Evropiane projektpropozimet e qëndrimit negociues për grup-kapitullin përkatës të *acquis*-it.”.

ë) Pika 5, e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator i paraqet për shqyrtim Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian projektpropozimet e qëndrimit negociues për grup-kapitullin përkatës të *acquis*-it, sipas parashikimeve të këtij vendimi, si dhe informon për rekomandimet e Komisionit për Çështjet Evropiane për qëndrimin negociues.”.

f) Pika 1, e kreut VII, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Sekretariati i Integritimit Evropian (sekretariati) është departamenti përgjegjës për integrimin, në Kryeministri.”.

g) Pika 3, e kreut VII, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Sekretariati i Integritimit Evropian, përveç detyrave funksionale në Kryeministri, ushtron edhe këto funksione: ...”.

gj) Pika 5, e kreut VII, shfuqizohet;

h) Në shkronjën “e”, të pikës 2, të kreut VIII, hiqen fjalët “... apo të kryetarit të delegacionit shtetëror.”;

i) Në pikën 3, të kreut VIII, fjalët “... me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.” zëvendësohen “... me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator.”;

j) Në pikën 9, të kreut VIII, fjalët “... janë përgjegjëse për dorëzimin pranë ministrisë përgjegjëse për Evropën të kontributit.” zëvendësohen me “... janë përgjegjëse për dorëzimin pranë ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator të kontributit.”.

2. Ngarkohen negociatorët, ministritë, institucionet e pavarura dhe institucionet në varësi të Kryeministrit dhe të ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama